

231
2010

12



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS


INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

**Projekt mbi ndërhyrjen konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës
"Shën Sotiri" (Sveti Spas), Kërçisht - Dibër
Tiranë, 2020**



Miratohet

Autor i projektit:
Gentian Vokopola



Shefi i Sektorit të Artit
Agron Islami


Miratohet

Sekretari i KKTkM-së
Arta Dollani



Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër



1. Vendndodhja, tipologjia dhe arkitektura

Kisha e "Shën Sotirit" (Sveti Spas) është e ndërtuar në pjesën e sipërme të fshatit Kërçisht në Maqellarë, 20 km në jug të qytetit të Peshkopisë. Kisha është e thjeshtë, njënefëshe me përmasa 6.30m x 3.40m dhe është e ndërtuar me gurë të lidhur me llaç (Fig.1). Çatia dyujëse e saj është e mbuluar me rrasa guri dhe hyrja e saj ndodhet në anën perëndimore. Në faqen lindore ndodhet apsida dhe anash saj dy niko (Fig.2). Faqet jugore dhe veriore janë ndërtuar nga dy harqe me gjatësi 2.80m e lartësi 3m. Faqja perëndimore ka në qendër derën hyrëse dhe një dritare të hapur me vonë. Tavani i kishës ka formë harkore me qemer dhe është i dekoruar me pikturë (Fig.3). Në interiorin e kishës ndodhet edhe një ikonostas i realizuar në një periudhë më të mëvonshme se ndërtimi i kishës, sipas një mbishkrimi në vitin 1874 (Fig.4). Sipër derës hyrëse në anën perëndimore ndodhet një nike e cila ka gjurmë afresku shumë të dëmtuar ku mendojmë se ka qenë realizuar portreti i "Shën Sotirit" emrin e të cilit mban kisha.

2. Piktura murale dhe gjendja e konservimit të saj

Të gjitha faqet e brendshme të kishës janë të dekoruara me pikturë në teknikën e afreskut. Nuk ka të dhëna për periudhën e realizimit të pikturës apo për autorët e saj ashtu si dhe për periudhën e ndërtimit. Piktura influencohet qartësisht nga piktura bizantine fakt që evidentohet në dy skenat më të plota "Fjetja e Shën Mërisë" dhe "Kostandini dhe Helena".

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër

Autor: G.Vokopola





Fig.1




Fig.2



Fig.3

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht - Dibër

Autor: G.Vokopola





Fig.4

Në përgjithësi piktura murale paraqet problematikë të konsiderueshme. Në zonën e apsidës vërehet humbje e imazhit piktorik për shkak të rënies së pelikulit, pranisë së kripërave si dhe nxirjeve nga ndezja e qirinjve. Intonako paraqet problemin e dekohezionit (shpërbërjes) për shkak të përgatitjes jo të mirë të tij. Për shkak të infiltrimit në faqet veriore dhe jugore kemi prani të shtuar të kripërave të karbonatit të kalciumit. Këto problematika vërehen edhe në faqen perëndimore, shkëputje e pelikulit nga intonako, rënie e intonakos, nxirje dhe depozitim kripërash. Në përgjithësi në të gjitha faqet vërehen edhe depozitime të tjera të paqëndrueshme si mbeturina qirinjsh, fole insektesh, gozhdë të ngulura në mur, etj. Sa i përket tavanit të kishës problematika më e madhe duket të jetë rënia e konsiderueshme e afreskut, pra një mungesë e madhe e pikturës murale.


Pelikuli piktorik.

- *Depozitime jo të qëndrueshme.* Sipërfaqja e pikturës është e mbuluar nga një shtresë pluhuri e krijuar nga pluhurat në atmosferë dhe punimet e ndryshme që janë kryer. Në disa pjesë vërehen prani e depozitimeve të insekteve, mbetje qirinjsh etj
- *Depozitime të qëndrueshme.* Në të gjithë sipërfaqen e mbetur të pikturës murale vërehet prani e madhe e kripërave (karbonatit të kalciumit) dhe nxirjeve.

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërcisht - Diber

Autor: G.Vokopola





- *Dekoezioni i pigmenteve (humbja e lidhjes).* Qëndrimi për një kohë të gjatë nën prezencën e lagështisë por dhe humbjes së aftësive lidhëse të karbonatit të kalçiumit ka bërë që të shfaqet problemi i shpërbërjes së pigmenteve.
- *Alterimi dhe abrazioni.* Lagështia e gjatë ka favorizuar dhe stimuluar abrasionin e patinës dhe pelikulit piktorik.
- *Lakunat (mungesa e plotë e pelikulit piktorik).* Në të gjithë sipërfaqen e pikturës evidentohet rënie e pelikulit piktorik duke krijuar lakuna të thellësisë e duke nxjerrë në intonakon.
- *Humbja e aderencës (ngjitjes).* Ky degradim ndodh për arsye të mos kryerjes së procesit të karbonatizimit në disa zona por dhe të lagështirës dhe prekjeve seko (në të thatë) duke bërë që pelikuli piktorik të shkëputet nga shtresa përgatitore.



Suporti

- *Humbja e aderencës (ngjitjes).* Në përgjithësi piktura murale paraqitet në një gjëndje të pastabilizuar dhe në disa zona janë krijuar shkoputje që rrezikojnë rënien e saj.
- *Mungesa të pjesshme të afreskut.* Këto mungesa janë trajtuar në ndërhyrje të mëparshme por ka ende zona të cilat nuk janë stukuar ose lakuna që janë krijuar me kalimin e viteve
- *Humbja e kohezionit (lidhjes) dhe abrazion i shtratit përgatitor (intonakos)* si pasojë e prezencës së lagështisë dhe humbjes së aftësive lidhëse të gëlqeres problematikë që vërehet në disa zona të veçanta.

Të gjithë problematikën në gjendjen e konservimit të pikturës murale po e ilustruam dhe me fotot që paraqesim në vazhdim.

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht - Dibër



Autor: G.Vokopola



Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht - Dibë

Autor: G.Vokopola








Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht - Dibër

Autor: G.Vokopola









Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht, Dibër

Autor: G.Vokopola





Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht, Diber

Autor: G.Vokopola



Sipërfaqet e pikturës sipas faqeve në m².

Faqja lindore rreth 18 m²

Faqja veriore rreth 35 m²

Faqja jugore rreth 25 m²

Faqja perendimore rreth 20 m²

Tavani rreth 24 m²

3. Metodologjia e ndërhyrjeve që do të kryhen

- *Depozitimet e paqëndrueshme (pluhurat)* do të pastrohen me kujdes me anë të tamponcinave të pambukut me ujë të distiluar, Ethanol dhe Açeton.
- *Humbja e lidhjes* tek pigmentet do të rikuperohet duke aplikuar direkt në afresk me penel Paraloid B72 në 2% në Metiletilketon (MEK) i cili avullon me shpejtësi dhe nuk i jep mundësi Paraloidit të depërtojë më në thellësi të pikturës duke kryer kështu një konsolidim të sipërfaqshëm të pigmentit të shpërbërë.
- *Depozitimet e qëndrueshme (nxirjet, kripërat)* do të pastrohen me Karbonat amoni 10% të tretur në ujë me anë të kompresave me arboçel e më pas duke kryer një shpëlarje të bollshme me ujë të distiluar e më fund duke thithur kripërat e aktivizuara në sipërfaqe me aplikimin sipër pikturës të letrave japoneze. Ndërsa mbivënit do të pastrohen me anë të bisturive.
- *Verniku i dekompozuar* do të pastrohet me Aceton dhe Etilacetat.
- *Humbja e adherences (lidhjes)* të pelikulit piktorik me intonakon. Kjo problematikë do të stabilizohet me përdorimin e Akрил 33 20 % të holluar në H₂O e Ethanol duke e injektuar me shiringë dhe me aplikim sipër me kartën Melinex.
- *Humbja e aderencës (lidhjes)* të intonakos me suportin do të stabilizohet me përdorimin e Ledan TB1 ose PLM me anë të injektimit me shiringa pasi të jetë kryer më parë hapja e rrugëve me H₂O dhe Ethanol si veikolant.

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht - Dibër

Autor: G.Vokopola




- 
- *Çarjet dhe mungesat e pjesëshme të afreskut do të mbushen me llaç të tonuar sa më pranë tonit origjinal të llaçit të vjetër proçes ky që përveç përmirësimit të anës estetike sjell dhe përforcimin e afreskut.*
 - *Të gjitha lakunat e bardha që shqetësojnë imazhin e pelikulit piktorik do të trajtohen me integrim piktorik duke kryer kështu unifikimin artistik të të gjithë pikturës.*

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale të kishës së "Shën Sotirit" (Sveti Spas), Kërçisht - Dibër

Autor: G.Vokopola



**Dokumentacioni grafik i kishës së Shën Sotirit (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër
(Faqja lindore)**



Depozitime të qëndrueshme (nxirje)



Goditje mekanike




Depozitime të qëndrueshme (kripëra)



Pelikul i dëmtuar



Dokumentacioni grafik i kishës së Shën Sotirit (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër
(Tavani në formë harku)





Depozitime të qëndrueshme (nxirje)

Depozitime të qëndrueshme (kripëra)



**Dokumentacioni grafik i kishës së Shën Sotirit (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër
(Faqja veriore)**






Depozitime të qëndrueshme (nxirje)



Depozitime të qëndrueshme (kripëra)



**Dokumentacioni grafik i kishës së Shën Sotirit (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër
(Faqja veriore)**




Rënie suvaje



Rënie e intonakos



Rënie e pelikulit



**Dokumentacioni grafik i kishës së Shën Sotirit (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër
(Faqja jugore)**



Rënie suvaje



Rënie e intonakos



Rënie e pelikulit




**Dokumentacioni grafik i kishës së Shën Sotirit (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër
(Faqja jugore)**






Depozitime të qëndrueshme (nxirje)

Depozitime të qëndrueshme (kripëra)




**Dokumentacioni grafik i kishës së Shën Sotirit (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër
(Faqja përëndimore)**



Rënie suvaje





Rënie e pelikulit




Rënie e intonakos



**Dokumentacioni grafik i kishës së Shën Sotirit (Sveti Spas), Kërçisht – Dibër
(Faqja perëndimore)**



Depozitime të qëndrueshme (nxirje)



Depozitime të qëndrueshme (kripëra)

